

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 1 nga 4</i>
<i>Departamenti i Burimeve Njerëzore</i>		<i>Sektori i Personelit</i>

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenin 5 (paragrafi 1, 2, 4, 5) dhe neni 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT-nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT Sh. A. për plotësim të pozitës si më poshtë shpall:

KONKURS PUBLIK

Titulli i vendit të punës:	Menaxher i Njesisë për zbatimin e projektit BESS në KOSTT
Ndërmarrja:	KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.
Numri referues:	1.0.6.0
Kohëzgjatja e kontratës:	Për kohë të caktuar deri në përfundim të projektit
Orari i punës:	Puna me orar të plotë
Lartësia e pagës bazë mujore:	1,707.56 euro
Numri i kryesve:	1
Kushtet e punës:	Puna në zyre dhe teren
Vendi i punës (lokacioni):	Selia Qendrore e KOSTT-it, Prishtinë
Mënyra e aplikimit:	Adresa elektronike (email)

Përmbledhje e programit Kompakt

Qeveria e Republikës së Kosovës (“Qeveria” ose “QK”) dhe Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit (“MCC”), agjenci qeveritare e Shteteve të Bashkuara, kanë nënshkruar një grant që synon përshtetimin e tranzicionit të vendit drejt një të ardhmeje energjetike që është më e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse, e besueshme dhe e përballueshme. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka ratifikuar programin Kompakt dhe ka caktuar Llogarinë e Sfidave të Mijëvjeçarit – Kosovë (MCA-Kosovë ose MCA-K) si subjekt përgjegjës për të ushtruar dhe përmbushur të drejtat dhe detyrimet e QK-së për të mbikëqyrur, menaxhuar dhe zbatuar programin Kompakt.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), si një nga partnerët zbatues të MCA-Kosovë, ka nënshkruar marrëveshjen me subjektin zbatues (IEA) me MCA-K, e cila e obligon KOSTT-in të krijojë Njësine për Zbatimin e Projektit BESS (PIU) për Aktivitetin aFRR (Aktiviteti i Reagimit të Restaurimit të Frekuencave), aktivitet ky i cili do të pajiset me staf dhe pajisje për t'i mbështetur konsulentët që kryejnë dizajnimin dhe mbikëqyrjen (D&S) dhe kontraktuesin që kryen dizajnimin dhe ndërtimin (D&B) me qëllim të zbatimit të projektit për Aktivitetin aFRR. Gjatë dizajnimin të projektit, stafi i ri i KOSTT-it i angazhuar në njësine për zbatimin e projektit BESS do të financohet nga Fondi Lehtësues i Kompaktit (CFF) deri në hyrjen në fuqi të Kompaktit, kurse më pas do të financohet nga fondet e Kompaktit.

Në përputhje me kërkesat e marrëveshjes me subjektin zbatues, dhe për ta kompletuar njësine e zbatimit të projektit BESS me staf, KOSTT-i po kërkon të rekrutojë një menaxher të njesisë së zbatimit të projektit

BESS për Aktivitetin e Reagimit të Restaurimit të Frekuencave, me detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

Përmbledhje e detyrave për pozitën: Menaxher i Njesisë për Zbatimin e Projektit BESS në KOSTT

Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT SH.A., Menaxheri i Njesisë për Zbatimin e Projektit BESS për Projektin aFRR. Menaxheri i PIU BESS në KOSTT do të shërbejë si pika kryesore e kontaktit me MCA-Kosovë, dhe është përgjegjës për menaxhimin e PIU, respektivisht ekzekutimin e përgjegjësive të KOSTT-it në kuadër të VNM-së. Menaxheri i Njesisë për Zbatimin e Projektit BESS do të veprojë në emër të KOSTT-it të gjitha çështjet që lidhen me projektin BESS, duke përfshirë komunikimin (dhe certifikimin sipas kërkesës) e të gjitha komentëve, miratimeve, autorizimeve dhe njoftimeve të tjera të Subjektit Zbatues tek MCA-Kosovë ose MCC-ja.

Vendi i punës është në Prishtinë, Kosovë.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Siguron përmbushjen e përgjegjësive të KOSTT-it sipas Marrëveshjes së Subjektit Zbatues të nënshkruar midis KOSTT-it dhe MCA-Kosovës, dhe koordinimin e tyre me MCA-Kosovë, në lidhje me Projektet aFRR dhe MFES.
- Bashkëpunon me MCA – Kosovë, Konsulentin për Mbikëqyrje Mjedisore dhe Sociale, Konsulentin D&S dhe udhëheqësit e ekipit të Kontraktorit të D&B për të siguruar fizibilitetin dhe zbatimin teknik të projektit dhe koordinimin e nevojshëm operacional.
- Mbështet MCA-Kosovë për të siguruar që konsulentët/kontraktorët përmbushin obligimet kontraktuale, duke përfshirë buxhetet dhe kostot, duke përcjellë piketat e projektit dhe raportimin në lidhje me to.
- Ofron të dhëna për prokurimin dhe liferimin e materialeve, pajisjeve, punëve dhe shërbimeve të nevojshme të projektit.
- Vlerëson dhe analizon rreziqet dhe sfidat e mundshme të projektit dhe propozon masa për të zbutur dhe eliminuar rreziqe të tilla.
- Udhëheq dhe menaxhon ekipin ndërfunksional të projektit të PIU BESS në KOSTT sipas organogramit të miratuar, duke caktuar detyra dhe përgjegjësi për anëtarët e ekipit të PIU BESS në KOSTT.
- Mbështet MCA-Kosovën në përgjegjësitë e saj të raportimit ndaj MCC-së në kuadër të Planit të Monitorimit dhe Vlerësimit përmes gjetjes së të dhënave dhe përmes angazhimit në ndryshimet në plan.
- Mbështet MCA-Kosovën në procesin e blerjes së tokës për vendin e BESS KOSTT (shpronësimin/servitutin eventual), në lidhje me Pëlqimet dhe Lejet Mjedisore, si dhe Kushtet dhe Lejet e Ndërtimit.
- Siguron pajtueshmërinë dhe respekton politikat, rregullat dhe rregulloret e shëndetit dhe sigurisë (SH dhe S) si dhe ato mjedisore.
- Raporton në lidhje me statusin e projektit, përditësimet dhe çështjet e mundshme me akterët dhe menaxhmentin e lartë ose me Komitetin Drejtues të projektit.
- Vendos dhe mban komunikim efektiv me akterët e projektit BESS në KOSTT.
- Siguron zbatimin e komponentëve përkatës të Planit të MCA-Kosovë për Integrim Social dhe Gjinor lidhur me aktivitetet e identifikuara në këtë Marrëveshje.

- Siguron një plan të angazhimit të stafit që do të përfshijë një strukturë organizative, duke përfshirë një plan gjinor dhe diversiteti që përshkruan qasjet për sigurimin e ekuilibrit gjinor në mundësitë e punësimit, trajnimit dhe ngritjes së shkathtësive.
- Punon me konsulentë/kontraktorë dhe partnerë të tjerë në kuadër të Paktit të Kosovës për të mbështetur qëllimet e projektit në lidhje me punësimin e femrave dhe fuqizimin ekonomik të grave.
- Mban dokumentacion të saktë të projektit, duke përfshirë planet e projektit, raportet e progresit, urdhrat e ndryshimeve kontraktuale dhe dokumentacionin e vendimeve të marra gjatë ciklit jetësor të projektit.
- Merr pjesë në komisionimin dhe testimin e aseteve të projektit BESS në KOSTT.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

Shkollimi: **Diploma universitare** (Diploma pasuniversitare ose diplomë tjetër ekuivalente e arsimit të lartë konsiderohet si avantazh)

Dega/drejtimi/lëmia: **Inxhinieri elektrike, Ekonomi, Administrim Biznesi ose fusha të ngjashme**

- Të ketë minimumi shtatë (7) vjet përvojë pune profesionale, nga të cilat së paku dy (2) vjet përvojë të dëshmuar në menaxhimin e projekteve dhe zbatimin e projekteve të infrastrukturës elektrike.
- Të ketë njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze në të shkruar dhe në të folur.
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyera organizative dhe të punës në grup.
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyera lidërshipi dhe motivim ekipor.
- Të jetë i ndjeshëm dhe i përshtatshëm në aspektin gjinor, kulturor, kombëtar dhe të moshës.
- Të ketë përvojë të mëparshme në menaxhimin e projekteve me kompleksitet dhe madhësi të ngjashme.
- Përvoja e mëparshme në promovimin e barazisë gjinore ose avancimin e grave në vendin e punës do të përbënte avantazh

Mënyra e aplikimit

Aplikimi është përmes email adresës elektronike. Dokumentet duhet të ngarkohen sipas kërkesave të konkursit. Pasi të dërgoni aplikimin tuaj përmes email adresës elektronike do të pranoni një email për konfirmim të pranimit të email-it tuaj. Nëse nuk keni pranuar email-in konfirmues, atëherë shkruani në email adresën punesimi@kostt.com (vetëm në rastin kur pas aplikimit nuk e keni pranuar email-in konfirmues).

Dokumentet që duhet të ngarkohen dhe dërgohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dërgimit të tyre:

Gjatë aplikimit për pozitën në fjalë kandidatët duhet të kenë kujdes hapat e aplikimit:

- Aplikimi bëhet vetëm përmes adresës (postës) elektronike (email) punesimi@kostt.com
- Në email për aplikim duhet të bashkëngjiten (ngarkohen) dokumentet si në vijim:
 - Aplikacionin-CV-në (**ver. 4.0**) të shkarkuar nga web faqja zyrtare e KOSTT Sh.A.: www.kostt.com
 - Dëshmia për kualifikimin profesional: Diploma universitare, e skanuar në formatin .pdf dhe e bashkëngjitur në email (nëse diploma është fituar jashtë vendit duhet bashkëngjitur vërtetimin e nostrifikimit të diplomës apo aktin që dëshmon se diploma është në procedurë të nostrifikimit me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë.

- Dëshmia për përvojën profesionale: Vërtetim pune (referencë) nga punëdhënësit tuaj të mëparshëm apo aktual me të cilën vërtetohet përvoja juaj për profesionin që keni. Në vërtetim (referencë) duhet të jetë data e fillimit dhe mbarimit të punësimit apo angazhimit tuaj tek punëdhënësi juaj.
- Dëshmi tjera të dokumenteve sipas kërkesave dhe kriterëve të konkursit publik.

Njoftimi me rezultatin e konkursit

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik aplikantët/kandidatët do të njoftohen pas çdo faze të zhvillimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve.

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë
Intervista deri në njëzet (20) pikë
Jetë përshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

KOSTT ofron mundësi të barabarta të punësimit për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe inkurajon kandidatët e gjinisë femërore dhe të rinjtë që të aplikojnë për këto vende pune.

Vërejtje: Gjatë aplikimit aplikantët/kandidatët duhet të kenë gjithashtu kujdes, si në vijim:

Nëse nuk e deklaroni që anëtari i familjes suaj është në marrëdhënie pune me KOSTT, në cilëndo fazë të zhvillimit të vlerësimit të kandidatit që vërtetohet, aplikacionet-CV-të tuaja do të refuzohen.

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa ato të mangëta ose ato që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen.

Aplikacionet do të pranohen vetëm nga kandidatët, të cilët i plotësojnë kërkesat/kriteret e konkursit të shpallur në mjetet e informimit dhe në webfaqen zyrtare të KOSTT-it.

Dokumentacioni shtesë të dërguara nga kandidati pas përfundimit të afatit të aplikimit nuk mund të kërkohej dhe as të pranohet.

Kalendari i përafërt: Pas përfundimit të afatit të aplikimit, brenda 20 dite testimi me shkrim, brenda 15 dite intervista, brenda 5 dite njoftimi final, si dhe brenda 15 dite lidhje e marrëdhënies së punës me kandidatin e suksesshëm.

Kalendari i përafërt do të aplikohet në rast se nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë të rrjedhës së procesit të konkursit sipas UA nr. 01/2024.

Dokumentet origjinale të cilat i vërtetojnë faktet e theksuara në aplikacion-CV duhet të prezantohen në momentin e intervistimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në webfaqen e KOSTT, nga data 26.04.2024 deri më 10.05.2024 ora 16:00.